



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL
PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE
TË EDUKIMIT FIZIK
2021**

1. HYRJE

Aftësia e mësuesve për ta bërë arsimimin e nxënësve “preokupimin” kryesor të ditës, kërkon përkushtim, përgjegjshmëri dhe standarde të larta në punë dhe në sjellje. Mësuesit veprojnë me ndershmëri dhe integritet, kanë njohuri të forta përmbajtësore, përdorin dijet dhe aftësitë e tyre, por në të njëjtën kohë përditësojnë njohuritë nëpërmjet vetëvlerësimeve të vazhdueshme, krijojnë marrëdhënie pozitive profesionale dhe punojnë me prindërit në interesin më të mirë të nxënësve të tyre.

Programi i zhvillimit profesional, për efekt marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës së edukimit fizik, sporte dhe shëndet, është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), për t’u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së edukimit fizik në përgatitjen për testimin kombëtar, për marrjen e kategorive të kualifikimit si dhe të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MASR-js ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- dokumentet zyrtare¹ të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë e mësimdhënie – nxënies;
- programet lëndore të edukimit fizik, sporte dhe shëndet;

¹Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASR-së që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë në mësimdhënie-nxëni dhe përdorimit të TIK-ut në procesin mësimdhënie – nxënie të lëndës edukim fizik, sporte dhe shëndet;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës sipas programeve lëndore të edukimit fizik, sporte dhe shëndet.

2. QËLLIMI I PROGRAMIT

Qëllimi i hartimit të programit të zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi është:

- të ofrojë një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së edukimit fizik, sporte dhe shëndet në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe DRAP-eve, ZVAP-ve, për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve. Në këtë aspekt, programi mund të plotësohet nga DRAP-et, ZVAP-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete;
- të ofrojë një program të detyruar për mësuesit që këtë vit do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar.
- **Nëpërmjet programit të kualifikimit, mësuesi përgatitet për testim. Ai:**
 - *njeh* dhe *zbaton* legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore;
 - *zotëron* kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
 - *demonstron* aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
 - *tregon* përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
 - *njeh* konceptin e gjithëpërfshirjes dhe *demonstron* përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
 - *demonstron* zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;

- *zotëron* zbatimin e rregullave drejtshkrimorë të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie - nxënies;
- *përdor* aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca.

3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Për secilën fushë përcaktohen:

- kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

FUSHA: DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR	
Kompetenca	Literatura e rekomanduar
“Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor”	
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe dispozitat normative të këtij sistemi; • zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore; • zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; • demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MASR-së; • zbaton etikën profesionale të mësuesit; 	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar • Udhëzuesi “Për fillimin e vitit shkollor 2020-2021”, ASCAP (Gusht 2020) • Shtojca 1 “Për disa plotësime në Udhëzuesin e fillimit të vitit shkollor 2020 – 2021” • Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020 • Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e

<ul style="list-style-type: none"> • respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; • respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; • zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit. 	<p>punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”</p> <ul style="list-style-type: none"> • Udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë” • Udhëzimi nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë” • Udhëzimi nr. 14, datë 28.07.2016 “Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë” • Urdhri Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë” • Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”
---	---

FUSHA: PROGRAME LËNDORE TE EDUKIMIT FIZIK SPORTE DHE SHENDET	
Kompetenca “Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të edukimit fizik në shkollë”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; • përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; • përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin dhe zbatimin e 	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza Kurrikulare, 2014 • Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2014 • Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016 • Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX dhe klasat X-XII • Udhëzues për zbatimin e programeve

<p>programit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësi të parashikuara në program; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxisin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; • harton rezultatet e të nxënit për tema mësimore ose grup temash, tematikash, në përputhje me rezultatet e të nxënit të programit; • kategorizon rezultatet e të nxënit të programit sipas niveleve të arritjes së të nxënit; • harton rezultatet e të nxënit specifike që u përgjigjen niveleve të ndryshme të nxënësve; • tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të edukimit fizik); • shpjegon lidhjen program mësimor - tekst nxënës; • përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e programit; • siguron informacion që demonstroi lidhjen e <i>edukimit fizik, sporte dhe shëndet</i> me shkencat e tjera dhe me jetën reale. 	<p>lëndore të edukimit fizik dhe sporteve</p>
--	---

**FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-
UT NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE**

<p align="center">Kompetenca I</p> <p align="center">“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e edukimit fizik, sporte dhe shëndet ”</p>	<p align="center">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; • përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve; • demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; • identifikoi nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me aftësi të kufizuara dhe nxënësit e talentuar); • planifikoi punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta; • edukoi të nxënësit dëshirën për t'u marrë me sport dhe aktivitete të ndryshme sportive; • organizoi mësimdhënien duke siguruar gjithëpërfshirjen e nxënësve në mbështetje të interesave individuale të tyre; • motivoi nxënësit, duke e konsideruar motivimin një çelës të progresit të tyre; • krijoi klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; • punoi me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit. • krijoi klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; • vlerësoi me objektivitet arritjet dhe rezultatet e nxënësve në fusha të ndryshme të sportit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015 • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017 • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz 2016 • Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), ASCAP 2018 • Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit me nxënësit e tij • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së edukimit fizik, sporte dhe shëndet në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018 • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së edukimit fizik, sporte dhe shëndet në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018 • Udhëzues për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë dhe për mbylljen e vitit shkollor 2019-2020, ASCAP, (Maj 2020)

Kompetenca II “Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e edukimit fizik, sporte dhe shëndet ”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një rezultati të caktuar; • përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e rezultateve të të nxëniet përmes krijimit të një situatë të nxëniet; • përdor metoda e teknika që nxisin dëshirën e nxënësve për t’u marrë me sport; • planifikon një orë mësimore duke u bazuar në hapat e metodologjisë së lojës (volejball, basketboll, futboll, hendboll etj.); • përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin fizik të nxënësve; • përdor metoda e teknika që sigurojnë pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje në orën e edukimit fizik; • demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; • shpjegon parimet e hartimit të një testi përmbledhës. 	<ul style="list-style-type: none"> • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017 • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz, 2016 • Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), ASCAP 2016 • Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, ASCAP 2018 • Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë. (<i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>), shtator 2019 • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së edukimit fizik, sporte dhe shëndet në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së edukimit fizik, sporte dhe shëndet në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018 • Modele testesh për arsimin parauniversitar (Teste të hartuara nga mësuesit), lënda: edukim fizik, sporte dhe shëndet • Udhëzues për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë dhe për mbylljen e vitit shkollor 2019-2020, ASCAP, (maj 2020) • Udhëzuesi “Për fillimin e vitit shkollor 2020-2021”, ASCAP (gusht 2020)
Kompetenca III “Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe të	Literatura e rekomanduar

komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në edukimin fizik, sporte dhe shëndet”	
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Realizon, në bashkëpunim me nxënësin, prezantime të evenimenteve sportive kombëtare e ndërkombëtare dhe zhvillimin e kampionateve të lojërave sportive dhe lojërave olimpike; • gjen dhe përdor materiale nga website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien në edukim fizik; • përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së <i>edukimit fizik</i> apo në projekte kurrikulare të integruara për fushën e arteve, të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materialesh nga website. 	<ul style="list-style-type: none"> • Literaturë që ka në fokus përdorimin e programeve kompjuterike që përdoren në klasat VI - IX të arsimit të mesëm të ulët si dhe në klasat X - XII të arsimit të mesëm të lartë dhe kanë në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie - nxënie

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT	
<p style="text-align: center;">Kompetenca</p> <p>“Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e</p>	<p style="text-align: center;">Literatura</p>

mësuesit”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i lëndës së edukimit fizik, sporte dhe shëndet:</i> <ul style="list-style-type: none"> njuh rregullat e etikës dhe të sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE	
Kompetenca	Literatura
“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”	
Rezultatet e pritshme: <i>Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet:</i> <ul style="list-style-type: none"> njuh rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; demonstron zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> Drejtshkrimi i gjuhës shqipe

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS	
Kompetenca	Literatura e rekomanduar
“Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së edukimit fizik, sporte dhe shëndet”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet:</i> <ul style="list-style-type: none"> shpjegon vlerat fizike konjiktive dhe afektive të veprimtarisë lëvizore dhe sportive; shpjegon parimet shkencore të të ushtruarit me aktivitet lëvizor dhe sportiv; 	<ul style="list-style-type: none"> Tekste dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës. Programe lëndore AMU, AML Udhëzues lëndor edukim fizik AMU,AML Librat: Metodika e edukimit fizik,

<ul style="list-style-type: none"> • argumenton kuptimin dhe shëndetin fizik e funksional (funksionet e aparatit respirator dhe kardiovaskular); • shpjegon me saktësi zhvillimin e fleksibilitetit, forcës muskulare, zhvillimin e aftësive koordinative; • përshkruan zhvillimin dhe ndryshimet fizike e trupore të nxënësve, nga njëri vit në tjetrin; • përshkruan teknikat dhe rregullat e organizimit të lojërave sportive (volejboll, basketboll, futboll, hendboll); • ofron këshilla profesionale për nxënësit që ushtrohen në mënyrë të pavarur me aktivitet sportiv; • shpjegon mirë faktorët e zhvillimit të përgatitjes së përgjithshme fizike (atletikë, gjimnastikë, fitnes); • mbledh informacion të saktë e bindës për nxënësit që duan të merren me aktivitete të ndryshme jashtë shkollës. 	<p>Didaktika e edukimit fizik; Edukim lëvizor; Lojërat lëvizore dhe edukimi(2004); Anatomi, Fiziologji ushtrimi; Volejboll; Basketboll; Gjimnastike; Atletikë; Futboll, Hendboll.</p>
--	---